



Strasbourg, 24 mars 2014

CDL-AD(2014)007

Opinioni nr. 751 / 2013

KOMISIONI EVROPIAN PËR DEMOKRACI PËRMES LIGJIT
(KOMISIONI I BENEDIKTIT)
DHE
DREJTORATI PËR DREJTAT E NJERIUT (DDNj)
I DREJTORATIT TË PËRGJITHSHËM PËR DREJTAT E NJERIUT DHE MBIZOTËRIMIN E
LIGJIT I KËSHILLIT TË EVROPËS

OPINION I PËRBASHKËT

MBI DRAFT LIGJIN

PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I KODIT GJYQËSOR
(SISTEMI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARË)

E ARMENISË

aprovuar nga Komisioni i Benediktit në
Seancën e 98të Plenare
(Benediktë, 21-22 mars 2014)
duke u bazuar në komentet e

Z. James HAMILTON (anëtarë zëvendësues, Irlandë)
Z. Johan HIRSCHFELDT (anëtarë zëvendësues, Suedi)
Z. Konstantine VARDZELASHVILI (anëtarë zëvendësues, Gjeorgji)
Z. Gerhard REISSNER (Ekspert, DDNj)

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje.....	3
II.	Shënime të përgjithshme.....	3
III.	Draft ligji që plotëson dhe ndryshon Kodin Gjyqësor	4
	A. Sistemi i vlerësimit	4
	1) Të përgjithshme	4
	2) Nenet Specifike	6
	B. Ndryshimet në procedurat në Kodin Gjyqësor	16
	C. Ndryshimet në masat disiplinore ndaj gjyqtarëve në Kodin Gjyqësor.....	16
	1) Të përgjithshme.....	17
	2) Nenet Specifike.....	18
IV.	Konkludimet.....	20

I. Hyrje

1. Komisioni i Benediktit ka pranuar një kërkesë për opinion mbi draft Ligjin që plotëson dhe ndryshon Kodin Gjyqësor të Armenisë përmes një letre të 12 nëntorit 2013 nga Z. Hrayr Tovmasyan, Ministër i Drejtësisë në Armeni.
2. Komisioni i Benediktit ka ftuar Z. James Hamilton, Z. Johan Hirschfeldt dhe Z. Konstantine Vardzelashvili për të vepruar si raportues për këtë Opinion të Përbashkët. Z. Gerhard Reissner, Kryetar i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian (KKGE) ka vepruar si raportues me kërkesë të Drejtoratit për Drejta të Njeriut i Drejtoratit të Përgjithshëm për Drejtat e Njeriut dhe Mbizotërimin e Ligjit (tash e tutje DDNJ).
3. Një delegacion i Komisionit Evropian ka qëndruar në Jerevan, Armeni nga 20-21 janar 2014 për t'u takuar me përfaqësuesit e Shoqatës së Gjyqtarëve, OJQ-ja për Mbrojtjen e Drejtave pa Kufi, Instituti i Shoqërisë Civile, Komisioni Armenian Helsinki, Këshilli për Drejtësi, Mbrojtësi i Drejtave të Njeriut, Komisioni i Shtetit dhe Çështjet Ligjore të Kuvendit Shtetëror dhe Ministria e Drejtësisë e Armenisë.
4. Ky opinion i përbashkët shqyrton informatat e marra gjatë vizitës së lartpërmendur.
5. Opinioni i Përbashkët aktual është aprovuar nga Komisioni i Benediktit në Seancën e 98të Plenare (Benediktë, 21-22 mars 2014).

II. Shënime të përgjithshme

6. Ky Opinion i Përbashkët është përgatitur duke u bazuar në dokumentet e dërguara nga autoritetet armene Komisionit të Benediktit që përbëhen nga përkthimi në gjuhën angleze i draft ligjit që plotëson dhe ndryshon Kodin Gjyqësor të Armenisë (tash e tutje draft Ligji), tekstin aktual të Kapitullit 17 të Kodit Gjyqësorë mbi detyrimet disiplinore të gjyqtarëve dhe ndërprerjen e kompetencave dhe Arsytimin për aprovimin e draft ligjit të propozuar ashtu siç janë paraqitur në dokumentin CDL-REF(2013)060.
7. Komisioni i Benediktit dhe delegacioni i DDNJ-së që ka shkuar në Armeni janë informuar në takim në Jerevan që ekzistonin edhe dy draft ligje tjera lidhur me çështjet mbi draft ligjin. Njëri paraqet Komisionin e ri për Etikë dhe Disiplinë kurse tjetri trajton procedurat e pranimit të Gjykatës së Lart.
8. Këto dy draft ligje tjera nuk janë përmendur në Arsytim që ishte dërguar Komisionit të Benediktit së bashku me draft ligjin. Megjithatë, është e qartë që ndryshimet që ato paraqesin, ndikojnë drejtpërdrejtë në draft ligj. Prandaj, me keqardhje mund të thuhet që Komisioni i Benediktit dhe DDNJ nuk kanë marr informatat për këto dy draft ligjet tjera të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e analizës në këtë Opinion të Përbashkët.
9. Draft ligji do të ndryshojë Kodin aktual Gjyqësorë në dy mënyra: (1) do të krijojë një sistem të vlerësimit për gjyqtarë dhe (2) do të paraqes ndryshimet në sistem disiplinorë. Sa i përket vlerësimit të gjyqtarëve, Arsytimi në draft Ligj qartas parasheh që duhet vendosur kritere objektive kuantitative dhe kritere subjektive kualitative për të siguruar që sistemi i vlerësimit të

jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe që duhet rregulluar. Fakti që një rezultat negativ në procedurën e vlerësimit mund të shpie tek një sanksion disiplinor duke përfshirë largimin, është mjaft problematik.

10. Opinioni i Përbashkët së pari do të trajtoj sistemin e ri të vlerësimit dhe pastaj ndryshimet në procedurat e Kodit Gjyqësor të përcjellë me ndryshimet në masat disiplinore ndaj gjyqtarëve në Kodin Gjyqësorë.

III. Draft ligji që plotëson dhe ndryshon Kodin Gjyqësorë

A. Sistemi i vlerësimit

1) Të përgjithshme

11. Sistemi i vlerësimit të gjykatës dhe drejtësisë në përgjithësi konsiderohet si një mjet i mirë për implementimin e vendimeve menaxheriale apo politike që kanë për qëllim përmirësimin e sistemeve në vijim; kurse, vlerësimi i performansës së gjyqtarëve individual shpesh konsiderohet që ndikon në pavarësinë e gjyqtarëve. Edhe pse ky rrezik mund të ekzistojë, nuk duhet të parandalojë vlerësimin. Por, është e rëndësishme që vlerësimi të ketë një bazë të fortë.
12. Sa i përket pavarësisë së gjyqtarëve, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësia të paraqitura së bashku në Opinionin nr. 1 (2001) të KKGJE mbi standardet lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve konkludon që shkelja e pavarësisë është çfarëdo ndikimi i jashtëm që mund të parandalojë gjyqtarin nga përmbushja e detyrës që iu është caktuar me Nenin 6 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (tash e tutje KEDN). Rekomandimi CM/Rec(2010)12 parasheh që “efikasiteti përfshin vendimet cilësore brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas një shqyrtimi të drejtë të çështjeve”¹. Prandaj: cilësia, brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe paanësia janë kushte të domosdoshme paraprake të cilat gjyqtari duhet plotësuar gjatë marrjes së vendimit.
13. Ushtrimi i pavarur detyrave nga ana e gjyqtarit mund të ndikohet nga autoritetet tjera shtetërore apo ndikim i papërshtatshëm që vjen nga vet gjyqësori.² Në këtë aspekt, delegacioni i Komisionit të Benediktit, gjatë qëndrimit në Armeni, kanë dëgjuar raporte këmbëngulëse të ndërhyrjes të pavend dhe të jashtëzakonshme nga gjyqtarë të gjykatave të instancave të larta tek ato të instancave të ulëta. Posaçërisht, që gjyqtarët e instancave të ulëta shpesh kërkojnë udhëzime nga gjyqtarët e instancave të larta – në veçanti nga ato të Gjykatës së Lartë. Në rast se këto pretendime janë të vërteta, atëherë duhet krijuar një qëndrim të fort në Armeni për të siguruar që **pavarësia e gjyqësorit përfshinë pavarësinë nga ndërhyrja e gjyqtarëve tjerë.**
14. Raporti i Komisionit të Benediktit mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësorë Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve parasheh që “parimi i pavarësisë së brendshme të gjyqësorit nënkupton që pavarësia e secilit gjyqtarë nuk është në pajtim me raportin vartësisë së gjyqtarëve në aktivitetin e tyre

¹ Rekomandimi CM/Rec(2010)12 I Komisionit të Ministrave të shteteve anëtare për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, paragrafi 31.

² Opinioni Nr. 1 (2001), KKGJE, paragrafi 66; Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësorë Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve (CDL-AD(2010)004), paragrafët 68-72.

gjyqësor vendim-marrës”³. Rekomandimi CM/REc(2010)12 parasheh që “Pavarësia e gjyqtarëve individual mbrohet nga pavarësia e gjyqësorit si tërësi”. Si e tillë, është aspekt fundamental i mbizotërimit të ligjit.”⁴ Dhe gjithashtu, parasheh që:

“22. Parimi i pavarësisë gjyqësore nënkupton pavarësinë nga çdo gjyqtarë individual në zbatimin e funksioneve gjyqësore. Gjatë marrjes së vendimeve, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm dhe të kenë mundësi të veprojnë pa ndonjë kufizim, ndikim të pavend, presion, kërcënim apo ndërhyrje, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga autoriteti duke përfshirë autoritetet e brendshme të gjyqësorit. Organizimi hierarkik i gjyqësorit nuk duhet të dëmtojë pavarësinë individuale.

23. Gjykatat supreme nuk duhet udhëzuar gjyqtarët për mënyrën se si ata duhet të vendosin në raste individuale, përpos në seanca paraprake apo gjatë vendosjes së këshillave ligjore në përputhje me ligjin”.

15. Gjykata Evropiane për Drejtat e Njeriut gjithashtu parasheh që pavarësia e gjyqësorit kërkon që gjyqtarët individual të jenë të lirë jo vetëm nga ndikimi nga jashtë gjyqësori, por edhe nga brenda. **Kjo pavarësia e brendshme e gjyqësorit kërkon që ata të jenë të lirë nga udhëzimet apo presioni nga kolegët gjyqtarë dhe nga udhëheqësit e tyre.**⁵
16. Në rastin e fundit Oleksandr Volkov kundër Ukrainës dhe në një vështrim më të përgjithshëm të pavarësisë së gjyqësorit, Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut parasheh që duhet organizuar disiplinën e gjyqësorit për të siguruar ndarje të mjaftueshme të gjyqësorit nga degët tjera të kompetencave shtetërore. Gjykata ka shtuar që për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit, që është një nga vlerat më të rëndësishme që përforcon funksionim efektiv të demokracisë, duhet ekzistuar garancion kundër abuzimit dhe keqpërdorimit të masave disiplinore.⁶
17. Ekzistenca e pretenduar e ndërhyrjes në pavarësinë e gjyqtarëve individual në Armeni nuk është vetëm shqetësuese, por gjithashtu thekson nevojën për vlerësim të duhur të sjelljes së gjyqtarëve në çdo nivel.
18. Kërkimi i udhëzimeve në raste individuale nga gjyqtarët e instancave të larta, të cilët do të vendosim për një apel, i parandalon palët nga shqyrtimi i pavarur i gjykimit të tyre dhe me këtë shkakton shkeljen e drejtës për qasje në gjykatë (Neni 6 KEDN dhe Neni 2 Protokollit 7 KEDN në rastet penale). Një praktikë e tillë (duke përfshirë dhënien e udhëzimeve) nuk është vetëm joefektive (një nivel i juridiksionit *de facto* është larguar) por gjithashtu bën shkeljen e drejtave të njeriut. **Praktika e tillë, nëse vazhdon, duhet trajtuar përmes masave disiplinore ndaj gjyqtarëve që marrin pjesë në një praktikë të tillë.**

³ Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve (CDL-AD(2010)004), paragrafi 72; Parimet e Bangallorit të Sjelljes Gjyqësore parashohin që “Gjatë realizimit të detyrave gjyqësore, gjyqtari do të jetë i pavarur nga kolegët gjyqtarë lidhur me vendimet të cilat gjyqtari është i obliguar të merr në mënyrë të pavarur”, Parimet e Bangallorit të Sjelljes Gjyqësore, 2002, Vlera 1 Pavarësia, 1.4.

⁴ Rekomandimi CM/Rec(2010)12, paragrafi 4.

⁵ Shih Gjykata Evropiane për Drejtat e Njeriut, rasti Parlov-Tkalcic kundër Kroacisë, aplikacioni nr. 24810/06, Gjykimi i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 86.

⁶ Shih Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut, rasti Oleksandr Volkov kundër Ukrainës, aplikacioni nr. 21722/11, Gjykimi I 27 majit 2013, paragrafi 199

19. Duhet cekur që çështja e vlerësimit të gjyqtarëve është çështje aktuale në disa vende të cilat janë duke konsideruar futjen apo rishikimin e sistemit të tyre të vlerësimit. Prandaj, CCJE ka vendosur të hartojë Opinionin Nr. 17 me lëndën “Drejtësia, vlerësimi dhe pavarësia”.⁷

2) Nenet Specifike

Neni 96.1 Aktivitetet vlerësuese të gjyqtarëve

20. Sistemi i drejtësisë në Armeni përbëhet prej tri niveleve: gjykata e instancës së lart, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lart (që zëvendëson sistemit dy-nivelesh që ekzistonte më herët dhe që përbëhej nga gjykatat e popullit dhe Gjykata Supreme). Neni 96.1 parasheh vetëm vlerësimin e gjykatave të instancës së lart dhe gjykatat e apelit. Nuk është e qartë pse Gjykata e Lart është e përjashtuar nga procesi i vlerësimit. Siç duket nuk ka dispozita specifike në Kushtetutë lidhur me Gjykatën e Lart dhe sistemi i caktimit duket të jetë i njëjtë sikur në gjykatat tjera. Shpjegimi i Komisionit të Benediktit dhe delegacionit të DDNJ-së dhënë në Armeni është që çështja e gradimit nuk ngrihet në këtë Gjykatë, pasi që është gjykata më e lart e shtetit.
21. Megjithatë, gjithashtu vlerësimi është i krijuar për të siguruar standarde të duhur të performansës duke përfshirë vet-analizën nga gjyqtarët dhe efikasitetin e rritur. Gjithashtu do të jetë e nevojshme identifikimi dhe reagimi ndaj shpërdorimit dhe prandaj nuk është e qartë pse Gjykata e Lart duhet përjashtuar nga një proces i tillë i vlerësimit. Gjithashtu, do të nevojiten statistika apo vlerësim kuantitativ i performansës së përgjithshme të Gjykatës.
22. Prandaj, Komisioni i Benediktit dhe DDNJ **rekomandojnë që Gjykata e Lart të përfshihet në sistemin e vlerësimit.** Kjo gjithashtu do të dërgojë një sinjal inkurajues dhe të dobishëm tërë gjyqësorit nëse gjyqtarët më të lart do të ishin pjesë e procesit të vlerësimit.
23. Sistemi i ri i vlerësimit ka një qëllim trefish: 1) të tregoj (identifikoj) për gjyqtarë mjetet për përmirësimin e efikasitetit, 2) të inkurajoj gjyqtarët për t’u angazhuar në vet-analiza dhe 3) të shërbejë si bazë për përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për gradim. Dy qëllimet e para duken për t’u lavdëruar, por i treti është më shumë kontrovers dhe shfrytëzimi i sistemit të vlerësimit për qëllime të tilla duhet pasur qasje të kujdesshme. Për shembull, derisa organi që vendos apo rekomandon mbi gradimin duhet pasur qasje tek vlerësimet, gjyqtari në fjalë duhet pasur mundësinë të shpjegojë apo sfidojë çdo gjetje të pafavorshme para atij organi. Sistemi i gradimit nuk duhet shfrytëzuar për të përjashtuar kandidatët nga shqyrtimi për gradim përpos nëse, ndoshta, gjyqtari vlerësohet që është në kategorinë më të ulët.
24. Një sistem i mire i vlerësimit të performansës do të funksionojë mirë nëse përdoret kryesisht si mjet për zhvillim dhe nëse ekziston bashkëpunimi ndërmjet personit që vlerësohet dhe vlerësuesit. Nëse konsiderohet që shpie tek pasojat siç janë përjashtimi nga gradimi, atëherë ky bashkëpunim mund të mos ofrohet me dëshirë. **Vlerësimi nuk duhet të konsiderohet si mjet për vëzhgim të gjyqtarëve, por në të kundërtën, si mjet për t’i inkurajuar ata të përmirësohen, që do të reflektohet në tërë sistemin.**
25. Është e rëndësishme që një numër i caktuar i çështjeve të qartësohen në këtë moment për të kuptuar cilat organe janë të përfshira në procesin e vlerësimit. Së pari, ekziston Këshilli

⁷ Kjo mund të mos jetë titulli përfundimtarë, por Opinioni do të trajtojë vlerësimin e gjyqtarëve.

Gjyqësorë (i themeluar sipas Kushtetutës) dhe Komisioni i Kryesuesve të Gjykatave (një organ vet-rregullues – por momentalisht kryesuesit caktohen nga Presidenti i Republikës). Këshilli i ri i Gjyqtarëve do të zëvendësojë Komisionin ekzistues të Kryesuesve të Gjykatave që duhet të jetë më demokratik në përbërje dhe funksione (nuk janë ofruar shënime tjera). Delegacioni i Komisionit të Benediktit ishte informuar në Armeni që këto ndryshime trajtohen në një draft ligji tjetër.

26. Si shtesë, Neni 96.1 parasheh që një Komision tjetër për Etikë dhe Disiplinë nën Këshillin e ri të Gjyqtarëve të organizojë dhe kryej vlerësimin. Ky Komision i ri do të themelohet nga ky draft ligji tjetër që për moment është në qarkullim dhe të cilin Komisioni i Benediktit nuk e ka parë.
27. Sipas Ligjit mbi Kodin Gjyqësorë të Armenisë⁸, funksioni i Komisionit aktual Disiplinorë të Këshillit të Drejtësisë është “të nisë procedurat disiplinore ndaj instancës së lart dhe gjyqtarëve të apelit dhe kryesuesve të gjykatës dhe të parashtojë mocion tek Këshilli i Drejtësisë”. Fuqizimi i Komisionit Disiplinor (Etikë) me detyrë për realizimin e vlerësimit – duke supozuar që ky Komisioni i ri do të trashëgojë këtë kompetencë – të bën të konkludosh që këto kryesisht do të përdoren për qëllime disiplinore. Prandaj, kjo mund të mos jetë një masë e mirë dhe mund të dërgojë sinjalin e gabuar.
28. Aq më tepër, përgjegjësia për vlerësim dhe përgjegjësia për disiplinë janë (dhe duhet të jenë) dy gjëra të ndryshme.
29. Neni 96.1.1 parasheh që vlerësimi duhet të bëhet çdo dy vjet. Kjo është një periudhë relativisht e shkurtë kohore. Një periudhë e tillë kohore krijon një sistem të vëzhgimit të përhershëm. Çdo procedurë e vlerësimit do të ketë ndikim mbi ata që janë duke u vlerësuar.
30. Ky propozim gjithashtu do të ngrit pyetjen e disponueshmërisë së fondeve të nevojshme për një procedurë të tillë. Gjithashtu duket të ketë një kundërshtim me Nenin 96.2.2 i cili parasheh që vlerësimi bazuar në kritere kuantitative do të bëhet në bazë vjetore.
31. Neni 96.1.4 parasheh që Këshilli i Gjyqtarëve do të përcaktojë procedurat, plan-programin dhe metodologjinë për vlerësimin e aktiviteteve të gjyqtarëve. Kjo është në përputhje me standardet ndërkombëtare: ekzistenca e parimit në ligj dhe besimi në Këshillin e Gjyqtarëve me shënime.
32. Draft ligji parasheh një formulë të hollësishtme që duhet të përdoret për shënime statistikore. Për kriteret kualitative, draft Ligji jo vetëm që bënë renditjen e këtyre kriterëve, por gjithashtu paraqet “aspektet” e tyre që duhet kontrolluar.
33. Draft Ligji parasheh një sistem të pikëve që duhet të përdoren: 60% e pikëve duhet dhënë kriterëve kuantitative (shih më poshtë), por shpërndarja konkrete e pikëve vet kriterëve duhet të vendoset nga Këshilli. Ky i fundit është gjithashtu përgjegjës për mënyrën e organizimit të analizave ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Prandaj, në njërin anë ekziston numri i çështjeve shumë të rëndësishme që i barten Këshillit, por në anën tjetër, Këshilli është i lidhur ngushtë me shënime.

⁸ Kodi Gjyqësorë i Republikës së Armenisë i aprovuar më 21 shkurt 2007, Neni 106, në dispozicion në internet: <http://www.court.am/upload/file/Judicial%20CodeEng%20Final-%20290607.pdf>

Neni 96.2 Kriteret për vlerësimin e aktiviteteve të gjyqtarëve

34. Neni 96.2 parasheh kriteret kualitative dhe kuantitative për vlerësimin e aktiviteteve të gjyqtarëve. Nuk ka ndonjë problem të dukshëm me shfrytëzimin e kriterëve kuantitative. Këtu duhet të ekzistojë një jehon e komenteve të grupit që ka hartuar Rekomandimet Kiev, posaçërisht “cilësia e performansës së gjyqtarit nuk mund të matet duke numëruar rastet e shqyrtuara pavarësisht kompleksitetit të tyre apo numrin e gjykimeve të mbështetura nga instanca e lart. Përderisa është pranuar që statistikak lidhur me rastet e shqyrtuara dhe shuma e anulimeve mund të jenë të dobishme për administrim gjyqësorë, menaxhim dhe buxhetim, ato nuk duhet të përdoren në dëm të gjyqtarit individual.”⁹
35. Gjithashtu, a duhet supozohet që të gjithë gjyqtarët do t’i nënshtrohen vlerësimin në mënyrë simultane? Duke marr parasysh që janë 230 gjyqtarë në vend, një vlerësim vjetor do të vendos një barrë të madhe administrative mbi organin e ngarkuar me tërë procesin.
36. Vlerësimi i kriterëve kuantitative bëhet çdo vjet, kurse ato lidhur me kriteret kualitative do të bëhen çdo të dytin vit. Si do të bashkohen këto dy vlerësime? A do të ketë vlerësim shtesë çdo dy vite që do të shqyrtojë rezultatet e vlerësimin të kriterëve kualitative dhe kriterëve kuantitative gjatë dy viteve të kaluara? Këtë duhet qartësuar. Neni 96.3.12 më poshtë nuk trajton këtë çështje në mënyrë të kënaqshme.
37. Po të kishte një matje e volumit të punës, do ishte e nevojshme të kishte sisteme për të vlerësuar peshën dhe vështirësinë e rasteve të ndryshme. Çdo gjykim kërkon një vlerësim të kohës optimale që duhet ndarë për secilin rast. Çdo menaxher i profesionistëve do të (apo duhet të) jetë i vetëdijshëm që personi që i nevojitet më shumë kohë për një punë mund të kryej një punë më të hollësishme. Thjeshtë, numërimi i rasteve të shqyrtuara mund të jetë çorientuese. Kryesisht, një matje e tillë mund të shërbejë si mjet i dobishëm për të identifikuar problemet potenciale, por nuk mund të bëjë më shumë se kaq dhe natyrisht që nuk duhet të jetë përcaktues i problemit.
38. Matja e “vështrimit të periudhave procedurale” (Neni 96.2.4.2), përsëri mund të theksojë problemin potencial, por është e rëndësishme që gjyqtarit ti ofrohet mundësia për të shpjeguar ndonjë mospajtim të dukshëm në këtë drejtim.
39. Matja e “stabilitetit të veprimeve gjyqësore” (Neni 96.2.4.3) është në dyshim. Në mënyrë efektive kjo nënkupton numërimin e apeleve të suksesshme. Duhet shmangur një matje të tillë pasi që përfshin një ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarit. Posaçërisht është e papërshtatshme në një sistem ku nuk aplikohet doktrina e precedentit detyrues. Atëherë kur të refuzohet një rast, kush mund t’ia qëlloj që gjykata e instancës së lart ka gabuar dhe gjykata e apelit ia ka qëlluar? Vendimi i gjyqtarit të gjykatës së instancës së parë e prishur nga Gjykata e Apelit më vonë mund të mbështetet nga vendimi i Gjykatës së Lart, Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut. Megjithatë, për shkak të dallimeve në afate kohore për procedurat e vlerësimin dhe shqyrtimi i rastit (apo çështjes ligjore) nga gjykata e lart apo organet gjyqësore ndërkombëtare (apo kvazi-ligjore), gjykata e instancës së parë mund të pranojë vlerësim negativë.

⁹ Shih takimi i ekspertëve mbi pavarësinë gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazi Jugor dhe Azinë Qendrore, 23-25 qershor 2010, OSCE/ODIHR, f. 14

40. Kufiri i anulimeve do të duhet të jetë mjaft i lart dhe rregulli i përjashtimeve për t'u caktuar nga Këshilli i Gjyqtarëve do të duhet të jetë mjaft zemërgjerë. Një sistem i tillë i vlerësimeve të vazhdueshme ka gjasa të krijoj një gjyqësorë të pasigurt që tërë kohën e kthen kokën në anën tjetër. Gjithashtu, zbatimi i saj në procedurat penale do të ishte posaçërisht i papërshtatshëm.
41. Neni 96.2.5 deri 96.2.7 parasheh një formulë shkencore për përcaktimin e performansës kuantitative të volumit të punës. Megjithatë, baza shkencore për këtë formulë është më shumë e dukshme se sa reale pasi që e tërë baza për përlogaritje mbetet në supozimin që rastet e caktuara gjyqtarit janë të drejta dhe të arsyeshme.
42. Si shtesë, edhe pse statistika të përpiluara në mënyrë të duhur mund të jenë mjet përgjithësisht i dobishëm për vlerësime, ato duhet analizuar në kontekst. Sipas disa raporteve, rastet e gjyqtarëve në Armeni rritet çdo vit dhe potencialisht mund të arrijnë një nivel të paqëndrueshëm. Sa është një gjyqtarë i aftë të shqyrtojë një numër të caktuar të rasteve në vit dhe nëse vazhdon rritja e rasteve, nuk do të ishte e drejtë të vlerësohet gjyqtari bazuar në përqindjen e rasteve të shqyrtuara pa analizuar arsyet për rritjen e rasteve. Gjithashtu duhet cekur që rastet e gjyqtarëve në gjykatën e instancës së parë janë zakonisht më të shumta se në gjykatat në nivele më të larta. Prandaj, proporcioni i rasteve të shqyrtuara dhe në pritje mund të jetë më i vogël në gjykatën e instancës së parë.
43. Propozimi sipas Nenit 96.2.9 për matjen e mesatares së kohëzgjatjes të shqyrtimit të rasteve është e papërshtatshme për arsye të ngjashme për ato që janë referuar më lart në lidhje me numërimin e rasteve në përgjithësi. Kush mund t'ia qëlloj që një gjyqtarë që i nevojitet më gjatë për një rast nuk është duke kryer punë më të hollësishme se sa kolegu më i shpejtë? Përdorimi i një mjeti të tillë menaxherial në procesin e vlerësimit duhet trajtuar me kujdes të veçantë pasi që do të ndikojë në pavarësinë e gjyqtarit. Gjyqtari që përpiqet të arrijë këto afate kohore mund të ndjej nevojën për të shpërfillur atë që normalisht do të ishte e nevojshme sipas ligjit dhe interpretimit e tij/saj të ligjit.
44. Është e vërtetë që shumica e rasteve që paraqiten pranë Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut janë ato që kanë shkelur Nenin 6 të KEDN për shkak të vonesave në procedurë. Por, me këtë kriter, një përqindje e caktuar e rasteve përtej kohëzgjatjes standarde nuk duhet, në vetvete, të jenë një e dhënë për pikët e vlerësimit, por mund të jetë pikënisje për një kontroll më të përgjithshme të këtij kriteri në situatën në fjalë.
45. Si shtesë, është e rëndësishme që për t'u pranuar rezultatet nga gjyqësori, detyra mjaft sfiduese e klasifikimit të rasteve dhe kohëzgjatja e analizës nga Këshilli të bëhet me përfshirjen e ekspertëve, gjyqtarëve me përvojë dhe Asociacionin e Gjyqtarëve në punën përgatitore.
46. Në përgjithësi, kriteret kualitative të parapara me Nenin 96.2.10 duket të jenë të përshtatshëm. Ai i cekë ato si në vijim:
- (1) Njohuritë ligjore
 - (2) Aftësitë profesionale
 - (3) Aftësitë komunikuese
 - (4) Aftësitë e komunikimit me kolegë
 - (5) Përfshirja profesionale dhe

(6) Aftësitë organizative (vetëm për kryesues të gjykatave)

47. Pesha e secilit kriter të lartpërmendur do të përcaktohet nga Këshilli.
48. Kriteri (1) Njohuritë ligjore sipas Nenit 96.2.10.1 është natyrisht një nga kriteret më të rëndësishme për vlerësimin e gjyqtarëve pasi që është kërkesë themelore.
49. Sipas Nenit 96.2.10.1.b “cilësia e arsytimit” shpesh paraqet problem në demokracitë e reja dhe duhet promovuar arsyetim koherent. Argumentim logjik, qartësi dhe aspektet tjera janë me interes dhe trajtohen në Opinionin Nr. 11 të CCJE mbi Cilësinë e Vendimeve Gjyqësore.
50. Kriteri (2) aftësitë profesionale, sipas Nenit 96.2.10.2 ngrit problemin se si matet “(a) aftësia për të përballuar presionin dhe kërcënimet” (shih Nenin 96.2.10.2.a). Nëse presioni apo kërcënim i bëhet në gjykatë të hapur, mund të arrihet gjykimi por presioni apo kërcënim i bërë jashtë skenës mund të mos jetë i njohur për vlerësuesin.
51. Në Nenin 96.2.10.2.b kriteri i referuar si “vështirimi i rregullave të sjelljes profesionale”. A është ky një kriter për etikën apo ka të bëjë me dispozitat ligjore për sjelljen profesionale? A ka të bëjë vetëm me rastet që rezultojnë në sanksione disiplinore kundër gjyqtarit apo a janë rastet apo incidentet gjithashtu relevante (cf. Neni 154 në Kodin aktual Gjyqësorë)?
52. Kriteri (3) Aftësitë komunikuese, sipas Nenit 96.2.10.3.d cekë “mirësjelljen” si një nga karakteristikat. Kjo ndoshta mund të jetë një karakteristikë etike dhe nëse është ashtu, atëherë ndoshta duhet cekur tek Kriteri paraprak (2) më lart. Por, mirësjellja gjithashtu është e lidhur me kulturën dhe personalitetin, që nuk mund të maten. Natyra e një person të drejtpërdrejtë, të ashpër apo të sinqertë mund të duket e pasjellshme për një person tjetër. Duhet pasur mundësi për të përshtatur dallimin brenda kufijve.
53. Kriteri (4) Aftësitë e komunikimit me koleg sipas Nenit 96.2.10.4 është i rëndësishëm edhe pse duhet të hyjë tek sjellja etike. Në raste të caktuara, për shembull kur të vendoset për gradimin e një gjyqtari të caktuar, kriteret relevante mund të jenë aftësitë profesionale si dhe karakteristikat personale, aftësitë komunikuese dhe aftësia për të punuar në ekip. Megjithatë, duke konsideruar implikimet potenciale të vlerësimit (që mund të rezultojnë në sanksione disiplinore), vlerësuesi duhet pasur qasje të kujdesshme ndaj raporteve në punë dhe raporteve ndërmjet kolegëve. Ka raste ku kolegët nuk kanë raporte të mira me njëri tjetrin, por dytë mund të jenë gjyqtarë të mirë dhe me menaxhim të duhur nevoja për bashkëveprim të tyre mund të minimizohet. Duhet cekur që nëse nuk vendoset mbrojtje e duhur për të minimizuar rrezikun nga konflikti i interesit, vlerësimi i raporteve ndërmjet kolegëve mund të ngrit çështje dhe të shkaktojë mungesë të besimit në tërë procesin e vlerësimit.
54. “Gatishmëria për të shkëmbyer njohuri dhe përvojën profesionale” mund të vendoset tek Kriteri (5) më poshtë.
55. Kriteri (5) Përfshirja profesionale sipas Nenit 96.2.10.5 bashkon disa aspekte të ndryshme të cilat duket të jenë të rëndësishme. Së paku, pjesëmarrja në trajnim është aq e rëndësishme sa që meriton të jetë kriter i ndarë. Megjithatë, pjesëmarrja në sindikatat profesionale nuk duhet të

jetë kriter për vlerësim. Gjyqtari individual duhet të jetë i lirë për të vendosur nëse dëshiron të bashkohet në ndonjë sindikatë.¹⁰

56. Kriteri (6) Aftësitë organizative sipas Nenit 96.2.10.6 nuk janë posaçërisht të nevojshme për kryesues të gjykatave por – ndoshta në ndonjë mënyrë pak më ndryshe – për çdo gjyqtarë. Disa vende kanë kritere të tilla që gjithashtu mbulon menaxhimin e rasteve dhe aftësinë për të menaxhuar volumin e punës në skemën e vlerësimit.
57. Gjithashtu duhet shqyrtuar bashkimin e Nenit 135 dhe Nenit 96.2.10 pasi që versioni i ri i Nenit 135 propozuar me draft Ligj gjithashtu renditë tetë kritere kualitative si shtesë ndaj grupit të kritereve. Grupimi dhe kushtet për kritere që përdoren në Nenin 135 duket të jenë më bindëse.
58. Neni 96.2.11 trajton kriteret kuantitative. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë është qëllimi këtu. Fjalja e parë duket të tregojë që vlerësimi i kritereve kuantitative të gjyqtarëve në gjykatën e apelit duhet të bëhet në mënyrë që gjyqtarët në panelin e njëjtë të kenë rezultat të njëjtë. Apo ndoshta ka për qëllim që paneli i gjyqtarëve në gjykatën e apelit ka lëshuar një vendim dhe kishte një opinion tjetër që gjykimi është refuzuar më vonë nga Gjykata e Lart – gjyqtari i cili parashtron opinionin e kundërt nuk do të “dënohet” në vlerësim? Sidoqoftë, është pak e çuditshme të bëhet dallimi në vlerësim ndërmjet gjyqtarëve në një panel. Çdo vlerësim i vendimeve aktuale të gjyqtarëve rrezikon tejkalimin e kufirit dhe ndërhyrjen në pavarësinë e gjyqtarëve që është vlerë themelore.
59. Në Arsyetim, autorët e draft Ligjit kanë theksuar që “vlerësimi i gjyqtarëve duhet të bëhet **kryesisht** prej gjyqtarëve”, dhe me këtë është sugjeruar që përpos gjyqtarëve, duhet pasur profesionistë tjerë ligjor të përfshirë në vlerësim. Megjithatë, nuk ka ndonjë indikacion lidhur me historikun dhe numrin e “jo-gjyqtarëve” të përfshirë në një vlerësim të tillë.
60. Gjithashtu nuk është e qartë nga draft Ligji nëse vlerësimi **kuantitativ** do të bëhet nga gjyqtarët. Neni 96.2.12 parasheh që vlerësimi **kualitativ** të bëhet nga kolegët gjyqtarë të përzgjedhur rastësisht që duket të jetë një mënyrë e duhur për të vazhduar tutje, por rekomandohet që vlerësimi të bëhet nga gjyqtarë të përzgjedhur rastësisht nga grupi i gjyqtarëve – preferohen gjyqtarë të pensionuar apo gjyqtarë që shërbejnë në nivel të njëjtë në sistemin gjyqësor sikur gjyqtari që është duke u vlerësuar. Rekomandohet që të gjithë vlerësuesit të vijojnë trajnim.
61. Draft ndryshimet nuk përbëjnë obligim për gjyqtarët (apo personat tjerë) të përzgjedhur për të kryer vlerësimin për të deklaruar ndonjë konflikt interesi apo për t’u larguar nga rastet ku vlerësuesi mendon që raporti profesional apo personal mund të ndikoj në vlerësim apo ku ekzistojnë rrethana që mund të ndikojnë në aftësinë e tij apo saj për të ofruar vlerësim të drejtë dhe të arsyeshëm të performansës së gjyqtarit.
62. **Draft Ligjit gjithashtu i mungon mekanizmi për shkualifikimin e vlerësuesit në një fazë të mëvonshme i cili nuk largohet apo nuk lajmëron ndonjë konflikt interesi.** Vlerësuesit duhet të jenë të obliguar të raportojnë çdo formë të komunikimit që synon ndikimin në procesin e vlerësimit përmes mjeteve të papërshtatshme (duke përfshirë por jo kufizuar në presionin, detyrimin apo forcën).

¹⁰ Rekomandimi CM/Rec(2010)12, paragrafi 25.

63. Draft Ligji gjithashtu duhet të përmbajë kërkesat për largim apo deklarim të konfliktit të interesit aty ku gjyqtarit i caktohet detyra e vlerësimit të kolegut brenda gjykatës së njëjtë apo Panelit të njëjtë.
64. Për të siguruar kredibilitetin e procesit të vlerësimit si dhe integritetin e punës, vlerësuesit duhet të jenë të obliguar – sipas ligjit – të ruajnë konfidencialitetin e rezultateve të vlerësimit.
65. Gjithashtu nuk është e qartë nëse apo në çfarë rrethanash gjyqtarët mund të refuzojnë të kryejnë vlerësimin.
66. Neni 96.2.12 sugjeron dy opsione të mundshme. Opsioni 1 parasheh vlerësimin nga prokurorë dhe avokatë në gjykatë dhe Opsioni 2 parasheh ndalimin ndaj prokurorëve dhe avokatëve nga pjesëmarrja në vlerësim.
67. Edhe pse secili opion ekziston në disa vende, vlerësimi i gjyqtarëve me përfshirjen e prokurorëve dhe avokatëve është një çështje shumë e ndjeshme.¹¹ Natyrisht, prokurorët dhe avokatët kanë mundësi të dinë fuqitë dhe dobësitë e gjyqtarëve. Megjithatë, ata nuk janë vëzhgues të paanshëm. Ekziston rreziku që një gjyqtarë të ketë raporte më të mira me ndonjë prokurorë apo avokatë për të siguruar vlerësim më të favorshëm apo mund të perceptohet që janë duke vepruar ashtu. Gjithashtu, ekziston rreziku në përfshirjen e prokurorëve në vlerësimin e gjyqtarëve në kulturën ligjore ku historikisht prokurorët kanë dominuar në gjyqësorë. Megjithatë, këto shqyrtime nuk do të kishin efektin e njëjtë nëse prokurorët apo avokatët e pensionuar do të përdroreshin si vlerësues.
68. Rreziku i komprometimit të pavarësisë së gjyqtarit mbizotëron ndaj përfitimit të njohurive potenciale dhe ekspertizës si vlerësues nga ana e prokurorit dhe avokatit. Prandaj Opsioni 1 nuk duhet të aprovohet dhe Opsioni 2 është qasja e preferuar.
69. Megjithatë, përdorimi i gjyqtarëve për të vlerësuar kolegët ka potencial për të shkaktuar vështirësi. Mund të shpie tek keqësimi i raporteve ndërmjet kolegëve dhe ka potencial për të ndikuar në moralin e gjyqësorit. Alternativisht, aty ku gjyqtarët pranojnë vlerësime të favorshme, kjo mund të rezultojë me deklarata për kronizëm (caktim i të afërmeve në pozita autoritative duke shpërfillur kualifikimet). Ekziston rreziku që sistemi i tillë të mos jetë i besueshëm.
70. Në përgjithësi, themelimi i një ekipi të përzier të vlerësuesve duke ftuar profesionist ligjor jashtë sistemit gjyqësor mund të jetë opsioni më i përshtatshëm. Me rëndësi është të themelohet një ekipi vlerësues me një përbërje të baraspeshuar. Kjo do të eliminoj kronizmin dhe perceptimin e vetëmbrojtjes. Si shtesë, vlerësimi mund të bëhet në mënyrë transparente dhe të paanshme.
71. Duket të ketë gabim teknik në Nenin 96.2.13: referenca në Pjesën 10 të Nenit 96.3 nuk është e saktë. Referenca duhet të jetë për Pjesën 12 të Nenit 96.3.
72. Neni 96.2.14 parasheh që duhet shqyrtuar “shënimet nga së paku pesë seanca gjyqësore”. Kjo duhet mirëpritur dhe kjo metodë mund të zgjerohet për të përfshirë numrin e seancave

¹¹ Shih Opinionin e draft Ligjit mbi ndryshimet në Kushtetutë duke përforcuar Pavarësinë e Gjyqtarëve dhe ndryshimet në Kushtetutë të propozuara nga Kuvendi Kushtetues i Ukrainës (CDL-AD(2013)014), paragrafi 39

dëgjimore dhe/ose rasteve dhe/ose numrin e caktuar të vendimeve për këshillat ligjore. Megjithatë, kjo punë duhet të bëhet nga gjyqtarë të pensionuar apo gjyqtarë që shërbejnë në nivelin e njëjtë të sistemit gjyqësorë sikur gjyqtari që vlerësohet.

73. Në Nenin 96.2.15-17 referenca duhet të jetë për Pjesën 12, jo Pjesën 11.
74. Sipas Nenit 96.2.16, Këshilli i Gjyqtarëve do të përshkruaj formatin e pyetësorit dhe raportet për vet-vlerësim. Këtu Këshilli do të ketë nevojë për ndihmën e ekspertëve, gjyqtarëve me përvojë dhe pjesëmarrjen e Asociacionit të Gjyqtarëve në mënyrë që të pranohen këto pyetësorë dhe raporte.
75. Neni 96.2.17 parasheh që identiteti i vlerësuesit të mbahet i fshehtë. Pasi që ky rregull nuk do të zbatohet në rastet kur rezultate e një vlerësimi kundërshtohen, është vështirë të kuptohet qëllimi i tij. Sidoqoftë, çdo sistem i vlerësimit duhet të jetë transparent. Identiteti i vlerësuesit mund të jetë shumë i rëndësishëm pasi që personi i përfshirë mund të ketë paragjykime ndaj gjyqtarit. Si shtesë, Arsytimi në faqen 47 (cf. f. 32) cek që “Gjyqtarët e përzgjedhur rastësisht do të vijojnë seanca të rastësishme gjyqësore të kolegëve të tyre gjyqtarë”. A mirëmbahet kjo qasje akoma? Nëse po, atëherë këtë duket cekur në mënyrë eksplicite këtu. Megjithatë, Komisioni i Benediktit dyshon që një procedurë e tillë është e këshillueshme.
76. Neni 96.2.18 – “Arsyetim i shkurtë” i vlerësimeve të dhëna nga vlerësuesi në një vlerësim të gjyqtarit mund të jetë i pamjaftueshëm. Nëse elementet objektive për të dëshmuar paanshmërinë nuk janë në dispozicion, një përshkrim më i gjatë apo argumentim duhet ofrohet për të shpjeguar pse ka vlerësuar vlerësuesi gjyqtarin në atë mënyrë. Kjo do t’i mundësoj gjyqtarit të ketë një vendim të arsyetuar duke iu referuar vlerësimit të tij apo saj të cilin ai apo ajo më pas mund të sfidojë para Këshillit.
77. Neni 96.2.19 – skema e propozuar e notimit për t’iu caktuar gjyqtarëve nuk është e rekomanduar pasi që krijon më shumë probleme se sa që zgjidh. Edhe pse duket e saktë, nuk është. Është subjektive – nëse përdoret pyetësori i propozuar apo gjyqtarë me përvojë – kjo mund të ndikojë në shpërndarjen e pikëve. Një vlerësim nuk ka nevojë për pikë të sakta. E rëndësishme është të dihet nëse një gjyqtarë i përmbush kriteret, ku janë pikat e forta dhe të dobëta të tij apo saj dhe si të përmirësohen kapacitetet e tij apo saj. Kjo mund të bëhet pa caktuar pikët. Vlerësimi i “përafërt” i paraparë në Nenin 96.3 për një rezultat të përgjithshëm gjithashtu mund të zbatohet në 10 kriteret dhe kjo do të jetë e mjaftueshme.
78. Sipas Nenit 96.2.20, pikët shpërndahen si në vijim: 60% për kriteret kuantitative dhe 40% për kriteret kualitative. Kjo mënyrë e notimit nuk është në përputhje me atë çfarë është përmendur në Arsyetim në faqen 31 duke përmend Rekomandimin Kiev ku thuhet që vlerësimi kuantitativ nuk duhet të jetë element kryesor i vlerësimit të aktiviteteve të gjyqtarit.¹² Si shtesë, pritet që të jetë e kundërta: një atributim më i madh kriterëve kualitative se sa kuantitative pasi që i pari përfshin aftësitë më të rëndësishme që një gjyqtarë duhet të ketë siç janë njohuritë dhe aftësitë personale. Përpos nëse ka keqdashje apo neglizhencë e përsëritur, kriteret kualitative nuk duhet të ndërliken me interpretimin e ligjit.

¹² Rekomandimi Kiev, f. 27

79. Opinioni Nr. 1 i CCJE, në paragrafin 27 thekson një shembull nga Lituania: “Shënimeve statistikore kanë një rol të rëndësishëm shoqëror në kuptimin dhe përmirësimin e punës dhe efikasitetit të gjykatës. Por, nuk janë të nejtë sikur standardet objektive të vlerësimit, pavarësisht a janë lidhur me një post të ri apo promovim apo ndryshe. Kujdes të veçantë duhet pasur në çdo përdorim të statistikës si ndihmë në këtë kontekst”. Edhe pse Komisioni i Benediktit nuk ka një mosbesim të përgjithshëm ndaj statistikave të krijuara mirë, parashtrahet pyetja nëse duhet vendosur kaq theks mbi kriteret kuantitative. Mund të zgjidhet një kompromis 50%-50%, që së paku do të dërgonte një sinjal të thjeshtë dhe neutral. Nëse kërkohet që gjyqtarët të përmbushin një standard minimal sipas kriterëve kualitativë dhe kuantitativë, atëherë një llokim relativ i pikëve ndërmjet këtyre dyjave do të kishte rëndësi më të vogël. Në realitet, është e qartë që ka gjyqtarë që janë më të aftë se efikas dhe e kundërta, por të gjithë do të dëshironim të kemi gjyqtarë që janë efektivë dhe të aftë.

Neni 96.3 Përmbledhja e rezultateve të vlerësimit të aktiviteteve të gjyqtarëve

80. Neni 96.3.1.2 i referohet Nenit 154.1 të Kodit aktual Gjyqësor që parashihet që “Komisioni” i Etikës do të diskutojë për raportet e caktuara (komunikimet) kundër gjyqtarëve përderisa raportet tjera rezultojnë me kërkesë për masa disiplinore. A janë të gjitha këto komunikime të pranuar relevante në procesin e vlerësimit dhe nëse po, atëherë si do të konsiderohen këto? A duhet një rast “i hapur” disiplinor, për të cilin nuk është vendosur akoma, të ketë ndonjë rëndësi në vlerësim?

81. Neni 96.3.3 parashihet që Komisioni për Etikë dhe Disiplinë duhet përgatitur format e vlerësimit individual për secilin gjyqtarë duke cekur pikët dhe ofruar arsytet për çdo kriter. Nuk është e qartë se çfarë mendohet me “pikë” – a jepen këto pikë nga vlerësuesi apo a bëhet përmbledhje e pikëve për secilin kriter apo a është rezultat i përgjithshëm?

82. Neni 96.3.5 – forma e vet-vlerësimit e përgatitur nga gjyqtari është shumë e rëndësishme. Gjyqtari i ka dy javë për të përgatitur atë. Kjo periudhë kohore mund të jetë shumë e shkurtër për të kontrolluar formën e vlerësimit.

83. Neni 96.3.5 duhet t’i referohet pjesëve 4 dhe 12 (jo 11) të Nenit 96.2.

84. Neni 96.3 rregullon vlerësimin e aktiviteteve të gjyqtarëve nga Komisioni për Etikë dhe Disiplinë i Këshillit të Gjyqtarëve me apel sipas Nenit 96.3.9 tek Këshilli i cili do të funksionojë si gjykatë. Nuk është e qartë se çfarë është menduar me këtë – nëse nënkupton që Këshilli do të zbatojë rregullat dhe mbrojtjen të cilën duket të zbatojë një gjykatë administrative, mund të jetë e arsyeshme, por fakti është që Këshilli i Gjyqtarëve nuk është gjykatë dhe nuk mund të jetë gjykatë. Nuk është e qartë nëse qëllimi i kësaj procedure është të përjashtojë referimin gjykatës së ligjit.

85. Sipas Kapitullit 13 të Kodit Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Gjyqtarëve përbëhen prej nëntë gjyqtarëve dhe katër persona tjetër (profesor të juridikut). Çdo vit themelohet komisioni disiplinor që përbëhet prej tre anëtarëve (prej cilëve dy janë gjyqtarë). A është ky komision që përfaqëson Këshillin dhe në kapacitet të vet që vepron si gjykatë? Apo a do të shërbejë ky Këshill i Gjyqtarëve në seanca plenare (pa anëtarë të komisionit) si një forum i apelit? Nëse Këshilli i Gjyqtarëve është një organ që përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e Armenisë, me siguri do të ishte shumë i madh për të vepruar në mënyrë efektive siç është paraparë në Nenin 96.3.9.

86. Në përgjithësi, **thjeshtë do të ishte e preferueshme të parashihet një ankesë gjykatës se sa një procedurë që përfshinë Këshillin e Gjyqtarëve.**
87. Neni 96.3.13 duket që paraqet një zgjedhje ndërmjet vlerësimit të kritereve kuantitative apo vlerësimit të kritereve kuantitative dhe kualitative. Kjo duket që bie ndesh me dispozitën 60% - 40% të Nenit 96.2.20.
88. Qëllimi i procesit të vlerësimit është i cekur në Nenin 96.1.2 (më lart). Njëri prej tyre “është të shërbejë si bazë për përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë gjatë hartimit të listës së gjyqtarëve për gradim”.
Megjithatë, nuk ka nevojë për arsyetim për themelimin e pozicionimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve. Kjo mund të shpie tek një garë e panevojshme ndërmjet gjyqtarëve që mund të ndikojë në vendimet e gjyqtarëve. Mund të mjaftoj pozicionimi i gjyqtarëve që kanë aplikuar për gradim. Si shtesë, do të zbatohet vlerësimi vjetor (vetëm kriteret kuantitative) që është e dyshimtë.
89. Qëllimi i hartimit të listës sipas Nenit 96.3.15 duke paraqitur të gjithë gjyqtarët dhe pozicionet e tyre me pikë të shpërndara për secilin, nuk është e qartë. Kjo listë duhet të dërgohet tek të gjithë gjyqtarët, Këshilli i Drejtësisë dhe stafit të Presidentit të Republikës. Lista është menduar vetëm për shfrytëzim të brendshëm. Duket jo reale që lista të ketë një qarkullim kaq të madh dhe të pritët të mbahet konfidencialiteti. Nëse lista e tillë bëhet publike, mund të ketë pasoja serioze për administrimin e drejtësisë. Si mund të reagojë një ndërgjyqës nëse rasti i tij apo saj i caktohet një gjyqtari i cili është në pozitë më të ulët në grup? Nuk ka arsye të mirë që këto informata të jenë në dispozicion Presidentit të Republikës. Asnjë arsyetim nuk është ofruar me Nenin 96.3.16 dhe Nenin 96.3.18 (dhe memorandumit shpjegues është i heshtur sa i përket kësaj).

Neni 96.4 Implikimet e vlerësimit të aktiviteteve të gjyqtarëve

90. Neni 96.4.1 kombinon implikimet e caktuara me rezultate të caktuara të vlerësimit. Kjo përfshin trajnimin e obligueshëm apo të rekomanduar; sanksionet disiplinore; pezullimin e drejtës për t'u përfshirë në listën e gradimit apo mundësinë e privilegjuar për t'u përfshirë në listën e gradimit.
91. Sipas Nenit 96.4.1 dhe Nenit 96.4.2 nëse një gjyqtarë vlerësohet me notë të dobët, kërkohet trajnim i obliguar dhe kjo është e përshtatshme. Por, mund të mos jetë e nevojshme apo e përshtatshme që Këshilli i Gjyqtarëve të urdhëroj një trajnim të tillë. Duhet të mjaftoj që gjyqtari në fjalë të jetë i obliguar të vijoj trajnimin në fjalë brenda periudhës së caktuar kohore.
92. Sipas Nenit 96.4.3 dhe Nenit 96.4.4 nëse gjyqtari vlerësohet me notë të dobët në dy apo tri vlerësime të njëpasnjëshme, çështja i nënshtrohet ankesës disiplinore. Kjo përsëri thekson papërshtatshmërinë e rolit të Komisionit për Etikë dhe Disiplinë në këtë çështje. Ky problem do të rregullohej nëse një Komision i pavarur dhe i specializuar për Vlerësim do të merrej me këtë çështje.
93. Si shtesë, përfitimet e aplikimit të sanksioneve të rastin e performancës së dobët janë mjaft të dyshimta posaçërisht lidhur me Nenin 153 sipas cilit gjyqtarët mund t'i nënshtrohen sanksioneve disiplinore në rast të “shkeljes së dukshme të normës substantive në procesin e

administrimit të drejtësisë”, “shkelje e dukshme e normës procedurale në procesin e administrimit” etj. Neni 153.2(10), (15) dhe (16) përcakton shkeljen serioze në rast se gjyqtari “(10) gjatë lëshimit të aktit juridik që nuk është në përputhje me parimet e sigurisë ligjore; “(15) merr vendim për të prishur procedurat e rastit që bën shkeljen e ligjit”; “(16) shkeljet tjera të dukshme të normave substantive apo procedurale që shpien tek kufizimi i drejtave të personit të garantuara me ligj apo tek privimi i drejtave dhe ka ndikuar apo mund të ketë ndikuar në lëshimin e aktit të duhur në rast”. Neni 153 duke qenë problematik, krijon rrezik më të madh nëse kombinohet me Nenin 96.4.3 dhe Nenin 96.4.4.

94. Neni 96.4.6 deri tek Neni 96.4.9 rregullon ndikimin e vlerësimit të gradim. Efekti i këtyre dispozitave është që virtualisht të bëjë që gradimi në mënyrë automatike të përcjell rezultatet e vlerësimit. Kjo është për arsye se jo vetëm kandidatët me nota të dobëta, por ata që kanë nota mesatare të përjashtohen nga gradimi kurse ata me nota të shkëlqyeshme kanë të drejtën e preferencës ndaj kandidatëve tjerë. Përderisa duket e arsyeshme të konsiderohen vlerësimet, ato nuk duhet të jenë faktori i vetëm përcaktues lidhur me gradimin.
95. Si shtesë, mundësia e Këshillit për të devijuar nga rregulli për të përfshirë gjyqtarët që janë notuar si të shkëlqyeshëm tri herë (paragrafi 7) është befasuese. Këshilli duhet të ofrojë “argumente substanciale” për të vepruar ashtu, por është e vështirë të paramendohet se çfarë argumenti mund të ofrohet për të përjashtuar një gjyqtarë të tillë.
96. Si shpjegim teknik, Pjesa 7 e Nenit 96.4 i referohet Pjesës 12 të Nenit të njëjtë dhe duhet t’i referohet Paragrafit 12 të Nenit 96.3. Nuk ka Pjesë 12 në Nenin 96.4. Si shtesë, në fund të Paragrafit 9, referenca duhet të jetë në Pjesën 7, jo Pjesën 6.

B. Ndryshimet në procedurat e Kodit Gjyqësor

97. Ka ndryshime të rëndësishme në Nenin 109 të kodit lidhur me procedurat e Këshillit të Drejtësisë. Këto parashohin që seancat e Këshillit do të mbahen para *kamerave* me përjashtim të rasteve lidhur me nënshkrimin e gjyqtarit veprimeve disiplinore (paragrafi 2). Rekomandohet që këto seanca – si rregull i përgjithshëm – të mbahen në publik dhe të mbahen para *kamerave* vetëm si përjashtim me kërkesë të gjyqtarit. Kjo do të ishte më shumë në përputhje me Nenin 6 të KEDN.
98. Parashtrohet edhe një pyetje, posaçërisht nëse ekziston drejta për ankim kundër vendimeve të Këshillit të Gjyqtarëve. Duket që nuk ka dispozitë për këtë.¹³
99. Neni 135 do të ndryshohet për të kërkuar anëtarët e Këshillit të Drejtësisë gjatë votimit me fletëvotime lidhur me hartimit e listës për gradim për të shqyrtuar rezultatet e vlerësimit dhe në veçanti aspekte të caktuara të vlerësimit. Ky Nen është ngatërrues. Së pari, nuk është e qartë çfarë është menduar me shqyrtimin e rezultateve. Edhe ashtu duket që nuk ka zgjedhje tjetër pasi që listat e gradimit duhet të përjashtojnë njerëz të caktuar dhe të preferojnë tjerët. Së dyti, pse janë përfshirë disa aspekte të vlerësimit në këtë listë dhe jo tjerët (ato të përjashtuar janë, përpos tjerash, aftësia për të mbajtur vet-kontrollin, duke pasur qëndrim të paanshëm ndaj pjesëmarrësve në procedurë, me kohë në seancat gjyqësore, mirësjellje, pjesëmarrja në shoqata profesionale të gjyqtarëve), kur në të njëjtën kohë i referohet kohës për të ruajtur reputacionin

¹³ Shih CDL-AD(2010)004 dhe KKGjE Opinioni Nr. 3, paragrafi 72

e gjykatës dhe vëzhgimin ndaj kodit gjyqësor të mirësjelljes të cilat në fakt nuk janë referuar në kriteret e vlerësimit, së paku jo shprehimisht.

100. Neni 135.2 parasheh që duhet shqyrtuar rezultatet e përgjithshme të së paku dy vlerësimeve të fundit gjatë hartimit të listës së gjyqtarëve për gradim. Kjo dispozitë i referohet Pjesës 8 të Nenit 96.3 por ndoshta këtu është menduar të citohet Pjesa 12 ose 13 e Nenit 96.3.

C. Ndryshimet në masat disiplinore ndaj gjyqtarëve në Kodin Gjyqësor

1) Të përgjithshme

101. Draft ligji përmban dispozitat që ndryshojnë Kapitullin 17 të Kodit Gjyqësor që trajton detyrimet disiplinore. Teksti i plotë i Kapitullit 17 është dorëzuar Komisionit të Benediktit dhe DDNJ vetëm për informim.
102. Detyrimi disiplinor kërkon shkelje të disiplinës. Performansa negative që shpie tek rezultatet e përgjithshme negative të vlerësimit gjithashtu mund të vijnë nga faktorë tjerë përpos shkeljes disiplinore. Prandaj, paraqiten probleme lidhur me propozimin që rezultatet e shpeshta të ulëta dhe negative shpijnë tek masat disiplinore nga Komisioni për Etikë dhe Disiplinë pasi që arsyet për rezultat negativ mund të jenë tjera përpos shkeljes disiplinore. Draft Ligji nuk bën dallimin ndërmjet implikimeve të vlerësimit dhe rezultateve të përgjithshme, ai thjeshtë i bashkon ato. Kjo shpjen tek një kombinim i padëshirueshëm i detyrimit disiplinor dhe vlerësimit.
103. Megjithatë, nevojitet mekanizmi për përjashtimin e atyre gjyqtarëve që nuk kanë aftësi për realizimin e funksionit të tyre në gjyqësorë. Në rast të tillë, nuk duhet pasur dënim automatik (psh zbritje të pagës etj) por një ekzaminim individual i rastit mundësisht duke përfshirë ndërmjetësimin etj.
104. Duhet cekur që, në disa aspekte, procedurat ekzistuese aktuale lidhur me procedurat disiplinore nuk janë në përputhje me standardet Evropiane. Në veçanti, duket që Komisioni Evropian mund të nisë ankesën dhe të bëjë vendimin fillestarë duke iu nënshtruar ankesës pranë Këshillit të Drejtësisë. Këshilli i Drejtësisë vepron si gjykatë në seancë dëgjimore (Neni 158) por pasi që në fakt nuk është gjykatë, duket që nuk është rregulluar çështja e ankesës në gjykatë kundër vendimit disiplinor.
105. Draft Ligji ofron një lidhje të fort ndërmjet vlerësimit dhe detyrimit disiplinor. Megjithatë, zbulimi i keqbërjes nuk duhet të jetë detyra kryesore e vlerësimit. Prandaj, edhe një herë është e dyshimtë nëse duhet të jetë organi i njëjtë – dmth Komisioni për Etikë dhe Disiplinë – që do të ketë juridiksion për vlerësimin dhe procedurat disiplinore apo nëse duhet të jetë organ i ndarë që t'i trajtoj ato.
106. Një argument shtesë për ndarjen e dy detyrave është përbërja e Komisionit Disiplinor e cila, sipas Nenit 106 të Kodit Gjyqësor përbëhet prej tre anëtarëve (dy gjyqtarë dhe një jo-gjyqtarë) për periudhën një vjeçare. Periudha e tillë e shkurtë kohore mund të mjaftoj për trajtimin e çështjeve disiplinore, por jo për një vlerësim. Kjo kërkon përvojën dhe duhet pasur konsistencë

dhe vlerësim të rregullt kohë pas kohe. Kjo mund të merret parasysh për Komisionin për Etik dhe Disiplinë.

107. Me rëndësi është që në fund të themelohet një sistem i duhur që është krijuar qartas në bazë të ligjit ku informatat për gabimet apo sjellje të keq të gjyqtarëve – duke përfshirë ato të zbuluara gjatë procesit të vlerësimit – të mund të vlerësohen në diskrecion dhe që mund të barten në procedurë disiplinore ku kjo është e përshtatshme.¹⁴
108. Përfundimisht, duhet theksuar që nuk janë të gjitha mangësitë në performansën e gjyqtarit shkelje disiplinore.

2) Nenet Specifike

Neni 153.1 Kohëzgjatja për nisjen e procedurave me qëllim për nënshtrim veprimeve disiplinore.

109. Ky Nen qartëson që kufizimi i kohës fillon me hyrjen në fuqi të vendimit përkatës. Ky është një hap pozitiv. Duhet eliminuar çdo ndërhyrje në procedurë para gjykatës.
110. Teksti i Neni 153.1 fillon me “1” por paragrafët tjerë nuk përcjellin këtë. Në fund të paragrafit 1 është një dispozitë (5) që i referohet Neni 153 (6). Ky është versioni i vjetër i Neni 153 përderisa në versionin e ri të Neni 153 me ndryshime me këtë draft Ligj, (6) nuk ekziston më. Prandaj, nuk është e qartë nëse pikat tjera të Neni 153.1 i referohen Neni të ri 153 apo versionit të vjetër.

Neni 153.2 Shkelja e qartë dhe serioze e normave substantive dhe procedurale

111. Neni 153.2 i ligjit ekzistues mbi detyrimet disiplinore parasheh gjashtë baza për detyrimet disiplinore. Këto, së pari janë shkelje të qarta dhe të mëdha të normave të ligjit lëndor, së dyti shkelje të qarta dhe serioze të normave të ligjit procedural, së treti shkelje të rregullta dhe serioze të disiplinës në punë, së katërti, shkelje të rregullta dhe serioze të kodit të mirësjelljes, së pesti moszbatimi i detyrave të caktuara sipas Kodit Gjyqësor dhe së gjashti mos-njoftimi i Komisionit për Etikë për ndërhyrje në drejtësi. Këtu mund të thuhet që në disa opinione, Komisioni i Benediktit ka kritikuar ndëshkimin e përgjithshëm të shkeljeve të kodit të etikës duke e konsideruar shumë të përgjithshëm dhe të paqartë dhe këmbëngul që nevojiten dispozita më të sakta aty ku duhet imponuar detyrimet disiplinore (Komisioni i Benediktit nuk ka parë Kodin e Mirësjelljes/Etikës)¹⁵.
112. Draft Ligji do të fshinte këtë nga lista e dispozitave lidhur me disiplinën në punë e cila tani do të trajtohet me procedurë të re të vlerësimit. Ajo do të shtojë si bazë për detyrim disiplinor, mospërmbushjen e detyrës për pjesëmarrje në trajnim të obligueshëm apo realizimin e detyrave të caktuara nga mbikëqyrësi provues.

¹⁴ Për më shumë informata, shih Opinionin mbi Ligjin e përgjegjësisë disiplinore dhe ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta në Gjeorgji (CDL-AD(2007)009), paragrafët 6-7

¹⁵ Shih, posaçërisht Opinionin e Komisionit të Benediktit mbi draft Kodin e Etikës Gjyqësore të Republikës së Taxhikistanit (CDL-AD(2013)035).

113. Draft Ligji propozon definimin se çfarë është menduar me shkelje të dukshme dhe serioze të normave substantive dhe procedurale. Përpyekja për këtë është e mirëpritur pasi që teksti ekzistues është i paqartë pasi që nuk përpiqet të shpjegojë fushështrirjen e dispozitës. Megjithatë, mund të ngrihet një numër i rezervimeve lidhur me përmbajtjen e definicionit të propozuar në Nenin e ri 153.2.
114. Draft Ligji definon shkeljen e dukshme si “shkelje e normave substantive dhe procedurale gjatë administrimit të drejtësisë, ekzistenca e cilës nuk mund të vihet në dyshim përmes supozimit të arsyeshëm ligjor apo argumentimit.” Kjo natyrisht e ngrit standardin shumë lart. Megjithatë, akoma do të ishte e preferueshme që shumica e këtyre çështjeve të trajtohen përmes ankesës apo shqyrtimit ligjor se sa të trajtohen si lëndë në procedurë disiplinore.
115. Definicioni i “shkeljes serioze dhe të dukshme” në Nenin 153.2.1 është një fillim i mirë për kufizimin e kësaj shprehje. Këtu gjithashtu mund të jetë vendi ku parimi i proporcionalitetit mund të shprehet drejtpërdrejtë.¹⁶ Megjithatë, është e nevojshme të kufizohet disipinimi që të mos përfshijë një interpretim të ligjit të arsyetuar mirë madje edhe nëse dallon nga rastet paraprake të instancave më të larta.
116. Neni 153.2 definon një sërë të shkeljeve procedurale si shkelje “serioze”. Disa prej tyre mund të kryhen me një shkallë më të ulët të fajësisë (psh aplikimi i normës që nuk është në fuqi, nënshtrimi i personave detyrimeve që nuk janë të parapara me ligj, lëshimi i vendimeve në kundërshtim me vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut) apo mund të jetë e hapur për interpretime të ndryshme (pikat 5 deri 10). Këto shkelje procedurale nuk duhet definuar si “serioze” që nga fillimi dhe duhet pasur vetëm detyrim disiplinor nëse këto shkelje bëhen në mënyrë të “madhe” dhe të qartë (se sa të “dukshme”).
117. Shkelja e kodit të mirësjelljes siç është paraparë me Nenin 153.2.3 nuk duhet të jetë bazë për veprime disiplinore. Masat disiplinore duhet ndërmarr në bazë të shkeljeve specifike disiplinore.
118. Baza për masa disiplinore siç është “vendimi për prishjen e procedurave në një rast të shkeljes së ligjit” (Neni 153.2) është e hapur për interpretim dhe potencialisht për aplikim të gjerë dhe prandaj “duhet ekzistuar një dallim ndërmjet interpretimit të pasaktë të ligjit bazuar në besimet e gjyqtarit në njërën anë dhe shkeljes së ligjit në anën tjetër”.¹⁷
119. Opinioni i Përbashkët i Komisionit të Benediktit me OSCE/ODIHR mbi Ligjin Kushtetues për Sistemin Gjyqësor dhe Statusin e Gjyqtarëve në Kazakistan gjithashtu rekomandon që “masat disiplinore kanë të bëjnë me keqsjellje profesionale të pafalshme por nuk duhet shkuar tek dallimi në interpretim të ligjit apo gabimeve gjyqësore”.¹⁸
120. Në Opinion mbi Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Ndjekjen Disiplinore të Gjyqtarëve të Gjykatave të Rregullta, Komisioni i Benediktit rekomandon që “...baza sipas cilës një gjyqtarë

¹⁶ Opinioni për Ligjin për përgjegjësinë disiplinore dhe ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve në gjykata të rregullta të Gjeorgjisë (CDL-AD(2007)009), paragrafët 4 dhe 16.

¹⁷ Opinioni për Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Ndjekjen Disiplinore të Gjyqtarëve të Gjykatave të Rregullta të Gjeorgjisë, CDL-AD(2007)009, paragrafi 21

¹⁸ Opinioni i Përbashkët mbi Ligjin Kushtetues për Sistemin Gjyqësor dhe Statusin e Gjyqtarëve në Kazakistan, CDL-AD(2011)012.

mund t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore përqendrohet ekskluzivisht në sjelljen e gjyqtarit gjatë diskutimit të rastit dhe gjatë lëshimit të vendimit. Prandaj, ato zbatohen në vet procesin gjyqësor, në interpretimit e ligjit nga gjyqtari gjatë shqyrtimit të rastit dhe në vet thelbin e funksionit të gjyqtarit dmth gjykim të pavarur. Kalon tek një sferë jashtëzakonisht delikate e vendim-marrjes së pavarur të gjyqtarëve në përputhje me kushtetutën dhe ligjin".¹⁹

121. Neni 155.5.7 i Kodit ekzistues i cili nuk do të ndryshohet gjithashtu duket të jetë problematik pasi që lejon masat disiplinore në rastet kur "një vendim gjyqësor i lëshuar nga një gjykatë ndërkombëtare duke vepruar me pjesëmarrjen e Republikës së Armenisë që konkludon që një gjykatë e Republikës së Armenisë ka bërë shkelje të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale të parapara me traktat relevant ndërkombëtarë ku është anëtare Republika e Armenisë...".
122. Prandaj, siç duket shumica e atyre që janë definuar si shkelje serioze kërkojnë ndëshkimin e gjyqtarit që merr vendim të gabuar. Kjo është e vërtetë për vendimet që janë në kundërshtim me Gjykatën Kushtetuese apo Gjykatën Evropiane për Drejtat e Njeriut, apo imponimin e masave të papërshtatshme të detyrimit. Disa nga bazat janë jashtëzakonisht të paqarta – për shembull, lëshimi i vendimit në shkelje të parimit të ndarjes dhe baraspeshimit të kompetencave. Dhe, nuk është e qartë se çfarë është menduar me nënshttrimin përgjegjësive disiplinore për lëshimin e vendimit që nuk është në përputhje me parimit e sigurisë ligjore. A do të thotë kjo që çdo vendim që nuk është në përputhje me praktikën paraprak do t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore? Vështirë është të mendohet për ndonjë ndërhyrje më të qartë në pavarësi gjyqësore. Fjala "shkelje serioze" e normave substantive dhe procedurale duhet të ndryshohet për të përjashtuar interpretimin e arsyetuar mirë të ligjit madje edhe nëse dallon nga praktika paraprake e instancave më të larta.²⁰ Megjithatë, virtualisht të gjitha çështjet e referuara në definicion mund të trajtohen përmes një sistemi funksional të apelit.
123. Në përfundim, këtu duhet përsëritur që një sistem i vlerësimit nuk duhet të konsiderohet si mjet për kontroll të gjyqtarëve. Në vend të kësaj, ai duhet konsideruar si mjet për inkurajimin e gjyqtarëve për të përmirësuar punën e tyre: "Vlerësime të rregullta të performansës së gjyqtarëve janë instrumente të rëndësishme që gjyqtari të përmirësoj punën e tij/saj dhe mund të shërbejë si bazë për gradim. Me rëndësi është që vlerësimi është kryesisht cilësor dhe përqendrohet në aftësitë profesionale, kompetencën personale dhe kompetencën sociale të gjyqtarëve. Nuk duhet pasur vlerësim në bazë të përmbajtjes së vendimeve dhe gjykimeve dhe në veçanti, duhet shmangur kriteret kuantitative siç është numri i anulimeve dhe pezullimeve si bazë standarde për vlerësim".²¹ Komisioni i Benediktit mendon që është më e rëndësishme që veprimet disiplinore të mos zbatohen këtu.

IV. Konkludimet

124. Draft Ligji që ndryshon dhe plotëson Kodin Gjyqësorë të Armenisë është një bazë e mirë për një sistem për vlerësimin e gjyqtarëve, madje edhe nëse duhet përmirësuar disa dispozita.

¹⁹ Opinioni i Komisionit të Benediktit për ligjin mbi përgjegjësinë disiplinore dhe ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta të Gjeorgjisë (CDL-AD(2007)009), të aprovuar nga Komisioni i Benediktit të Seancës e 70të Plenare (Benediktë, Mars 2007), paragrafi 18.

²⁰ Shih Opininionin mbi Ligjin mbi përgjegjësinë disiplinore dhe ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta të Gjeorgjisë (CDL-AD(2007)009), f.3

²¹ Opinioni i Përbashkët mbi Ligjin Kushtetues të Sistemit Gjyqësor dhe Statusin e Gjyqtarëve të Kazakstanit, paragrafi 55, CDL-AD(2011)012.

125. Megjithatë, Komisioni i Benediktit dhe DDNJ ishin të interesuar të mësonin për ekzistencën e pretenduar të ndërhyrjeve në pavarësinë e gjyqtarëve individual në Armeni që vjen nga elementet më të larta të gjyqësorit. Kjo nuk është vetëm shqetësuese, por duhet trajtuar praktikën dhe eliminuar para se të themelohet një sistem i duhur i vlerësimit. Në një sistem të vlerësimit, fenomeni i tillë duhet të identifikohet dhe raportohet. Kjo është një arsye bindëse për vendosjen e një vlerësimi të duhur të sjelljes së gjyqtarëve në çdo nivel të shtetit, duke përfshirë nivelin e Gjykatës së Lart.
126. Edhe pse vendosja e një sistemi të vlerësimit të gjyqtarëve dhe reformat në sistemin disiplinorë në Armeni janë padyshim të nevojshme, duhet trajtuar një numër të çështjeve fundamentale lidhur me kuptimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe posaçërisht të gjyqtarëve individual.
127. Duhet theksuar qartas që pavarësia e gjyqësorit përfshin edhe pavarësinë e gjyqtarëve individual nga ndikimi pavarësisht a burojnë nga brenda gjyqësorit apo nga jashtë. Kjo do të thotë që secili gjyqtarë individual është i pavarur të ushtroj funksionet gjyqësore të tij apo saj. Gjykatat supreme nuk duhet adresuar udhëzime gjyqtarëve për mënyrën se si të vendosin në raste individuale me përjashtim të seancave paraprake apo gjatë vendosjes për këshillat ligjore në përputhje me ligjin. Por, gjyqtarët e instancave të ulëta nuk duhet të kërkojnë udhëzime nga gjyqtarët e gjykatave të instancave të larta për funksionet e tyre gjyqësore.
128. Komisioni i Benediktit dhe DDNJ kanë dhënë disa rekomandime për disa çështje të ngritura nga draft Ligji të cilin autoritetet Armeniane duhet të trajtojnë. Rekomandimet në vijim janë bazuar në standardet minimale ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare:
- a) Themelimi i një ekipi të përzier të vlerësuesve me shumicë të gjyqtarëve që punojnë së bashku me profesionist ligjor jashtë sistemit aktual gjyqësor;
 - b) Edhe pse kriteret kuantitative dhe kualitative të përzgjedhura për vlerësim dhe procedurë (përfshirja e gjyqtarëve në fjalë) janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duhet shikuar idenë e vlerësimit të secilit kriter sipas pikëve dhe përlllogaritjes së rezultatit të përgjithshëm të vlerësimit bazuar në këto pikë;
 - c) Lista e pozitave të arritur me këto pikë në vlerësim rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve dhe prandaj nuk duhet të vendoset;
 - d) Duhet shpjeguar aplikimin e të gjitha kriterëve (kuantitative dhe kualitative);
 - e) Është i dyshimtë vlerësimi i aktiviteteve të gjyqtarëve nga Komisioni i ri për Etikë dhe Disiplinë i Këshillit të ri të Gjyqtarëve me ankesë Këshillit që do të funksionoj si gjykatë. Vlerësimi dhe disiplina duhet të jenë dy procese të ndara. Preferohet të rregullohet çështja me një ankesë gjykatës se sa një procedurë që përfshin Këshillin e Gjyqtarëve;
 - f) Hartimi i statuteve që iu është besuar Këshillit duhet të bëhet me pjesëmarrjen e ekspertëve, gjyqtarëve me përvojë dhe Shoqatës së Gjyqtarëve;
 - g) Anketat e gjykatave (duke përfshirë prokurorët dhe avokatët) që mund të shfrytëzohen për vendime menaxheriale nuk janë zgjedhja më e mirë për vlerësimin e gjyqtarëve. Mund të jenë të njëanshme dhe nuk do të ketë konflikt të interesit dhe ndikim të pavend në gjyqtarë;
 - h) Nisja e procedurave disiplinore duke u bazuar në rezultatet e përgjithshme nga një vlerësim nuk duhet të jenë e mundur. Ligji duhet të theksojë faktin që detyrimi disiplinor nuk mund të paraqitet pa sjellje të gabuar të gjyqtarit dhe ushtrim të paligjshëm të funksionit (dmth detyrimi disiplinor kërkon një shkelje të disiplinës);

- i) Duhet shikuar një procedurë tjetër disiplinore në largimin e gjyqtarëve të cilët nuk mund të përmbushin detyrat e veta;
- j) Duhet vendosur një mekanizëm për shkualifikim të vlerësuesit në një fazë të mëvonshme nëse ai ose ajo nuk largohet apo nuk raporton ndonjë konflikt të interesit;
- k) Nuk duhet definuar të gjitha shkeljet procedurale si shkelje “serioze”.

129. Si shtesë, Gjykata e Lart duhet të përfshihet në sistemin e vlerësimit. Kjo gjithashtu do të dërgojë një sinjal inkurajues dhe të dobishëm tërë sistemit gjyqësor nëse gjyqtarët më të lart do të ishin pjesë e procesit të vlerësimit.

130. Me rëndësi është që në fund të themelohet një sistem i mirë i vlerësimit, që është i rregulluar me ligj ku informatat mbi gabimet apo keqsjelljet e gjyqtarëve – duke përfshirë ato të zbuluara gjatë procesit të vlerësimit – të mund të vlerësohen në diskrecion dhe që të mund të barten në procedurë disiplinore nëse është e nevojshme.

131. Komisioni i Benediktit dhe Drejtorati për Drejtat e Njeriut mbesin në dispozicion të autoriteteve Armeniane për çfarëdo ndihme shtesë që mund t’iu nevojitet atyre.